



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 14, Datë 16.01.2025

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “SAMASOL” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13, dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.01.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 115 prot., datë 14.01.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “SAMASOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “SAMASOL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1854 prot., datë 02.09.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 MW, në Fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 185, datë 12.09.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.09.2024 dhe 14.09.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 23.09.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1927 prot., datë 16.09.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.
- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, ku me shkresën nr. 1854/3 prot., datë 30.09.2024, ERE e ka njoftuar atë për vendimin nr. 185/2024 dhe ka evidentuar informacionin/dokumentacionin e munguar të lidhje me këtë aplikim, shoqëria ka dorëzuar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1854/5 prot., datë 11.10.2024. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, është konstatuar se ende mungon një pjesë e informacionit/dokumentacionit të nevojshëm. Për këtë arsye, me vendimin e bordit

të ERE-s nr. 217, datë 16.10.2024, u vendos zgjatja e afatit të vendimmarrjes së bordit me 30 (tridhjetë) ditë.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, rezulton se ajo ka depozituar dokumentacion plotësues për aplikimin me shkresat e protokolluar në ERE me nr. 1854/10 prot., datë 11.11.2024 dhe nr. 1855/12 prot., datë 13.11.2024.
- Me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit të fundit të dorëzuar dhe/ose zhvillimin e një korrespondence të mundshme me shoqërinë, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 243, datë 14.11.2024, u vendos zgjatja deri jo më vonë se data 27.01.2025 e afatit të vendimmarrjes së bordit në lidhje me aplikimin e shoqërisë “SAMASOL” sh.p.k.
- ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 1854/14 prot., datë 27.11.2024, duke e njoftuar për vendimin e marrë nga bordi i ERE-s dhe duke i kujtuar se, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, rezulton se një pjesë e tij ende duhet plotësuar. Në vijim, me shkresën nr. 1854/15 prot., datë 10.12.2024 shoqëria ka depozituar dokumentacion e kërkuar.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; dhe për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “SAMASOL” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me MIE-n, Kontratën nr. 10517 rep., nr. 4879 kol., datë 28.12.2023.
 - Ka marrë miratimin për lidhjen e centralit fotovoltaiik me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., nr. 7252/3 prot., datë 10.10.2022:
 - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 06.12.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaiik me fuqi 2 MW, nga shoqëria “SAMASOL” sh.p.k.
- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, nr. 10517 Rep., nr. 4879 Kol., datë 28.12.2023, specifikohet se ajo lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare për panelet fotovoltaiike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të Kontratës nr. 10517 Rep., nr. 4879 Kol., datë 28.12.2023, të nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të fillojë punimet brenda 90 ditëve nga pajisja me të gjitha lejet (me të cilat nuk është pajisur akoma) dhe se do të vendosë në punë centralin brenda 12 muajve nga pajisja me këto leje. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet

kusht shoqërisë që të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të kësaj kontrate.

- Rezulton se shoqëria ka një VNM të vlefshme deri më datë 06.12.2026, ndaj vlerësohet që në kuadër të mbikëqyrjes shoqëria të raportojë çdo 3 (tre) muaj në ERE në lidhje me fillimin e punimeve brenda këtij afati.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “SAMASOL” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të përcaktuara nga kontrata me MIE-n.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SAMASOL” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “FTL” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI